V E N D I M
Nr.229, datë 28.4.1999

PËR MËNYRËN E FUNKSIONIMIT DHE TË ORGANIZIMIT TË KOMISIONIT TË MBIKËQYRJES SË SIGURIMEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 76 të ligjit nr.8081, datë 7.3.1996 "Për veprimtaritë e sigurimit dhe të risigurimit", me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve, që më poshtë do të quhet "KMS", ushtron funksionet e tij në përputhje me ligjin nr.8081, datë 7.3.1996, si dhe me aktet e tjera ligjore e nënligjore, të nxjera në bazë e për zbatim të tij.

KMS-ja ushtron kompetencat e dhënies së autorizimit, si dhe të mbikëqyrjes së veprimtarisë të sigurimeve dhe të risigurimeve nga shoqëritë vendase ose të huaja, subjekte të ligjit nr.8081, datë 7.3.1996 (këtu më poshtë të quajtura "shoqëri sigurimi"), për mbrojtjen e interesave të të siguruarve, nënshkrues dhe përfitues të sigurimeve.

PËRBËRJA, KOMPETENCAT DHE FUNKSIONIMI I KMS-SË

2. Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve është krijuar dhe funksionon në përputhje me ligjin nr.8081, datë 7.3.1996 "Për veprimtaritë e sigurimeve dhe risigurimeve", me seli në Tiranë.

Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve e ka emërtimin e shkurtuar "KMS".

3. Përbërja e KMS-së

KMS-ja përbëhet nga kryetari, dy nënkryetarë dhe katër anëtarë. Kryetari i KMS-së emërohet nga Këshilli i Ministrave, ndërsa nënkryetarët dhe anëtarët emërohen nga ministri i Financave, me propozimin e kryetarit të KMS-së.

4. Kompetencat e KMS-së

KMS-ja është organ kolegjial, vendimor dhe, në përmbushjen e funksioneve, nxjerr vendime, udhëzime dhe rregullore. KMS-ja ushtron këto kompetenca:

4.1. Mban regjistrin e shoqërive të sigurimit dhe/ose të risigurimit, si dhe të ndërmjetës të sigurimit dhe të risigurimit.

4.2. Shpreh gjykimin dhe vendos për kërkesat për dhënie autorizimi, për ushtrimin e veprimtarisë të sigurimit dhe/ose të risigurimit.

4.3. Kryen kontrollin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së sigurimeve dhe të risigurimeve, nëpërmjet monitorimit të dokumenteve, raportimeve statistikore, revizioneve dhe auditimit.

KMS-ja e realizon kontrollin e shoqërive të sigurimit, kryesisht nëpërmjet personelit kontrollues të veprimtarisë që ushtrojnë shoqëritë e sigurimit, për të mbikëqyrur këto veprimtari dhe për të mbrojtur interesat e të siguruarve.

4.4. Ndjek prirjet e zhvillimit të tregut të sigurimeve, duke pasur parasysh kërkesat ekonomiko-sociale të vendit, duke iu referuar në mënyrë të veçantë tregut ekonomik europian, si dhe verifikon e kontrollon realizimin e këtyre prirjeve, duke evidencuar masat e mundshme, për t'u dhënë atyre impulse të mëtejshme.

4.5 Ndjek dhe mbikëqyr operacionet teknike, financiare dhe tregtare, si dhe veprimtaritë e tjera të shoqërive të sigurimit, të cilat, në mbështetje të akteve ligjore e nënligjore, duhet të realizohen në përputhje me kriteret dhe kushtet e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse. Gjithashtu, KMS-ja ndjek dhe mbikëqyr bazueshmërinë e këtyre veprimtarive në plane biznesi, si dhe me treguesit e justifikimet e programit të veprimtarisë, që sipas ligjit, janë të miratuara nga KMS-ja.

KMS-ja ka të drejtë dhe detyrim të marrë vendimet përkatëse, për të garantuar që veprimtaria e shoqërive të sigurimit të ushtrohet në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore përkatëse, me planet korresponduese të biznesit dhe me programin e veprimtarisë, që është miratuar sipas ligjit, si dhe të shmangë abuzimet dhe veprimet e tjera të qëllimshme, që rrezikojnë interesat e të siguruarve.

KMS-ja mund të kërkojë, që, në përputhje me ligjin, një plan biznesi dhe programi i miratuar i

veprimtarisë së shoqërisë të sigurimit të ndryshohet përpara se të miratohen kontrata të reja sigurimi. Nëse është e nevojshme, për ruajtjen e interesave të të siguruarve, KMS-ja mund të ndryshojë ose të përfundojë një plan biznesi me efekt për kontratat ekzistuese të sigurimit ose për kontratat që nuk janë përfunduar ende.

4.6. Merr masat e duhura për informimin e publikut, kërkon dhe ndjek zbatimin e procedurave ligjore për ndalimin e veprimtarisë dhe dënimin sipas ligjit të çfarëdo subjekti që kërkon të ushtrojë apo që ushtron veprimtari sigurimi dhe risigurimi pa u pajisur paraprakisht me autorizimin përkatës të KMS-së apo në tejkalim të llojeve të veprimtarive siguruese e risiguruese, që janë të parashikuara në autorizimin e lëshuar prej tij.

4.7. Revokon, pjesërisht ose tërësisht, vleshmërinë e autorizimit zyrtar që i është dhënë një shoqërie sigurimi, për të ushtruar veprimtari sigurimi dhe/ose risigurimi.

4.8. Bën propozime dhe merr vendimet përkatëse për shoqëritë e sigurimeve, veprimtaria e të cilave është në kundërshtim me interesat e të siguruarve, ose nëse rrezikohet aftësia paguese e tyre.

4.9. Merr masa dhe vendos sanksione në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të sigurimit, duke përfshirë edhe atë të nënshtrimit ndaj likuidimit të detyrueshëm administrativ.

4.10. Kufizon, ndryshon ose ndalon investimet që mund të rrezikojnë stabilitetin financiar të shoqërive të sigurimit ose që kanë efekte të dëmshme në veprimtarinë e tyre të sigurimit a të risigurimit, me qëllim garantimin e interesave të të siguruarve.

4.11. Kontrollon pajtueshmërinë me aktet ligjore e nënligjore përkatëse të planeve të biznesit dhe të programeve të veprimtarisë, të paraqitura nga shoqëritë e sigurimeve.

4.12. Kontrollon e kërkon ndryshimin e kushteve dhe të tarifave në policat e sigurimeve, të paraqitura nga shoqëritë e sigurimit, kur këto nuk përputhen me aktet ligjore e nënligjore të fushës së sigurimeve.

4.13. Mbikëqyr dhe ushtron kontroll për çdo marrëdhënie financiare, të vendosur ndërmjet shoqërive kontrolluese dhe të kontrolluara dhe që janë të lidhura me shoqëritë që ushtrojnë veprimtari sigurimi dhe/ose risigurimi.

4.14. Kryen inspektime dhe kontrolle për blerjet e mundshme, edhe për efekt të së drejtës së parablerjes të aksioneve të vet shoqërive të sigurimit nga persona apo grup personash, fizikë a juridikë, që janë përfshirë në procedura të çfarëdoshme administrimi të detyruar, ose që janë përfshirë në procedura falimentimi a likuidimi të detyrueshëm administrativ, me marrjen dijeni për këto rrethana, pavarësisht nga mënyrë e ardhjes së informacionit.

4.15. Vendos pezullimin e përkohshëm të nja a më shumë personave që mbajnë funksione drejtuese në shoqëritë e sigurimit, si dhe t'i sugjerojë organit kompetent largimin a shkarkimin e tyre nga detyra dhe funksioni që kanë, kur çmohet se është në rrezik ose cenohet stabiliteti i veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit.

4.16 Kërkon kopje të reklamimeve dhe të njoftimeve që bëhen nga shoqëritë e sigurimit, që publikohen nga masmedia dhe merr masat përkatëse në rast parregullsie.

4.17. Merr pjesë në mbledhjet e organeve drejtuese të shoqërive të sigurimit, me përfaqësues të dërguar prej tij, si dhe rekomandon thirrjen e mbledhjeve të organeve drejtuese të shoqërive, kur e sheh të nevojshme.

4.18. Kryen dhe ndjek, në përputhje me kompetencat që ka sipas akteve ligjore e nënligjore, të gjitha procedurat e nevojshme ligjore në rastet e falimentimit të shoqërive të sigurimit.

4.19. Përgatit projektakte ligjore e nënligjore dhe i paraqet për miratim në organet kompetente, bën propozime për amendamente dhe ndryshime të legjislacionit të sigurimeve, si dhe shqyrton e jep mendime për projektaktet ligjore e nënligjore që lidhen me veprimtarinë e sigurimeve dhe të risigurimeve.

4.20. Kryen studime dhe jep kontributin e vet në hartimin e politikës shtetërore për sigurimet, zhvillimin dhe promovimin e veprimtarive të sigurimit dhe të risigurimit, si dhe për orientimet për investimet e shoqërive, që ushtrojnë këto veprimtari.

4.21. Bën ekzaminime, analiza dhe përgatit publikime për zhvillimin e tregut të sigurimeve e të risigurimeve.

4.2.2. Organizon konferenca, seminare e takime për çështje që u takojnë apo lidhen me veprimtari të sigurimeve dhe të risigurimeve, si dhe merr pjesë në konferenca dhe seminare analoge të organizuara nga autoritetet mbikëqyrëse analoge.

4.23. Miraton rregulloren për të drejtat dhe detyrimet e personelit profesional dhe rreuglloren

për kryerjen e kontrollit mbi shoqëritë e sigurimeve, si dhe përcakton kriteret e konkurseve për marrjen në punë të personelit, duke caktuar kritere për detyra të ndryshme, fushat objekt të provimeve, të cilat mund të jenë me gojë ose me shkrim, duke treguar kriteret e vlerësimit.

4.24. Miraton rregulloren e brendshme të KMS-së, e cila do të përcaktojë normat e përgjithshme, që kanë të bëjnë me ndarjen e detyrave, si dhe ato që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me disiplinimin dhe administrimin e shpenzimeve

4.25. Jep mendim, brenda 31 marsit të çdo viti, për bilancin përfundimtar të vitit të mëparshëm dhe për raportin vjetor rreth veprimtarisë së zhvilluar nga KMS-ja, i cili i dërgohet për miratim Ministrit të Financave.

4.26. Jep mendim, brenda 30 nëntorit të çdo viti, për bilancin preventiv ose paraprak të shpenzimeve që duhen të përballohen në vitin e ardhshëm, i cili i dërgohet për miratim Ministrit të Financave.

4.27. KMS-ja ushtron edhe kompetenca të tjera, që i njihen apo i ngarkohen në mbështetje të akteve ligjore dhe nënligjore.

PROCEDURAT E MBLEDHJES SË KMS-SË

5. KMS-ja mblidhet, si rregull, dy herë në muaj, me kërkesën e kryetarit, e cila përmban dhe rendin e ditës. Dokumentacioni përkatës vihet në dispozicion jo më vonë se tre ditë përpara ditës së caktuar për zhvillimin e mbledhjes.

6. Komisioni duhet të thirret brenda 10 ditëve nga paraqitja e kërkesës me shkrim, në rastet kur së paku tre prej anëtarëve të tij kanë bërë kërkesë, dke treguar argumentet që duhet të përmbajë rendi i ditës.

7. Mbledhjet drejtohen nga kryetari i KMS-së ose, në mungesë të tij, nga nënkryetari me i madh në moshë.

Për vlefshmërinë e mbledhjeve është e mjaftueshme prania e jo më pak se e pesë anëtarëve. Në çdo mbledhje duhet të jetë i pranishëm kryetari i KMS-së ose, në rast se mospjesëmarrja e tij në mbledhje bëhet për shkaqe objektive, në mbledhje duhet të marrë pjesë të paktën njëri nga nënkryetarët e tij.

8. Çdo anëtar i KMS-së ka të drejtën e një vote. Vendimi është i vlefshëm kur votojnë jo më pak se katër anëtarë.

9. Çdo anëtar i KMS-së duhet të kërkojë heqjen dorë ose nuk mund të lejohet të marrë pjesë në një mbledhje të KMS-së, kur ndërmjet tij dhe personave apo shoqërive për të cilët diskutohet, shqyrtohet, vlerësohet dhe kryhet çfarëdolloj procedurash për çështje konkrete, ka lidhje bashkëshorte, gjinie, krushqie, apo ka shkaqe të tjera interesash, që vënë në dyshim paanshmërinë dhe objektivitetin në dhënien e votës.

Në lidhje me kërkesën për të hequr dorë nga pjesëmarrja në diskutim a votim apo për përjashtimin prej tyre, vendimet merren nga KMS-ja, sipas procedurës së përcaktuar më lart.

10. Funksionet e sekretarit i besohen një nëpunësi të KMS-së. Sekretari redakton procesverbalin e mbledhjes së KMS-së.

11. Aktet e KMS-së regjistrohen dhe nxirren me nënshkrimin e kryetarit.

12. Procesverbalet, të nënshkruara nga kryetari dhe nga sekretari, pasmiratimit të tyre, arkivohen sipas një rendi kronologjik, në një libër dhe ruhen nga sekretari.

13. KMS-ja publikon çdo vit një raport për veprimtarinë e saj, i cili përfshin edhe të dhënat sinjifikative për veprimtarinë e sigurimeve kombëtare dhe europiane, si dhe studime, artikuj, tema të tjera që lidhen me tregun e sigurimeve.

KRYETARI I KMS-SË

14. Kryetari i KMS-së emërohet nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit të Financave.

Kryetari drejton veprimtarinë e KMS-së dhe ushtron këto kompetenca:

14.1. Përfaqëson KMS-në në marrëdhënie me të tretët.

14.2. Nënshkruan, me emër të KMS-së, marrëveshje ndërkombëtare në fushën e sigurimeve.

14.3. Thërret dhe drejton KMS-në dhe ndjek zbatimin e vendimeve të tij.

14.4. Formon grupe pune duke përfshirë edhe ekspertë e specialistë në ushtrimin e funksioneve të KMS-së.

14.5. Merr masat e duhura dhe ndjek administrimin e shpenzimeve në kufijtë e fondit të caktuar për këtë qëllim në buxhetin e KMS-së.

14.6. Përgatit relacionin vjetor për veprimtarinë e zhvilluar nga KMS-ja, i cili i bashkëlidhet bilancit përfundimtar.

14.7. Ushtron kompetenca të tjera sipas dispozitave ligjore e nënligjore.

15. Heqja dorë nga detyra e kryetarit të KMS-së i paraqitet organit që ka bërë emërimin dhe i komunikohet KMS-së. Me paraqitjen e dorëheqjes, deri në emërimin e kryetarit të ri, detyrat e kryetarit i ushtrojnë bashkërisht të dy nënkryetarët.

16. Në ushtrimin e funksioneve, kryetari ndihmohet nga dy nënkryetarët e KMS-së, të cilët mbulojnë përkatësisht:

16.1. problemet e teknikave të sigurimit të shoqërive, si dhe ndjekjen në vazhdimësi të zhvillimit të tregut të sigurimeve, për t'i dhënë impulse të reja ecurisë së tij (nënkryetari teknik);

16.2. fushën e kryerjes së kontrollit mbi shoqëritë e sigurimeve dhe mënyrën e administrimit të veprimtarisë ekonomiko-financiar të KMS-së (nënkryetari i kontrollit).

Detyrimet për të komunikuar me KMS-në

17. KMS-ja në çdo kohë, mund të shqyrtojë dhe të kontrollojë drejtimin dhe marrëdhëniet financiare të një shoqërie sigurimi dhe nëse rezervat e shoqërisë ekzistojnë e administrohen sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

18. Aksionerët, organet drejtuese, përfaqësuesit, agjentët, brokerët e një shoqërie, që kryejnë ose kanë kryer veprimtari për shoqërinë e sigurimit, me kërkesën me shkrim të KMS-së, i paraqesin këtij të fundit apo personave të ngarkuar zyrtarisht prej tij, të gjitha librat, dokumentet apo regjistrime të tilla që kanë rëndësi për vlerësimin e operacioneve të veprimtarisë dhe të marrëdhënieve financiare, si dhe i japin KMS-së të gjithë informacionin e kërkuar.

19. KMS-ja ka të drejtë të dërgojë në mbledhjet e organeve drejtuese të shoqërive të sigurimit përfaqësuesit e vet, të cilët duhet të dëgjohen në çdo kohë. Gjithashtu, KMS-ja mund t'u rekomandojë shoqërive të sigurimit të shqyrtojnë në mbledhje çështje të veçanta, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e sigurimeve dhe të risigurimeve.

20. Procesverbalet e mbledhjeve dhe kopje të vendimeve të organeve drejtuese apo vendimore të shoqërive të sigurimeve duhet t'i dërgohen KMS-së nga drejtoria, këshilli mbikëqyrës, nga çdo organ tjetër i shoqërisë, nga personat që, shprehimisht, janë të autorizuar nga asambleja e ortakëve apo e aksionerëve, si dhe statuti, brenda 15 ditëve nga data e marrjes së tyre.

Personeli profesional.

Kompetencat e inspektorëve kontrollues

21. Inspektorët kontrollues emërohen nga kryetari i KMS-së, në bazë të një testimi profesional.

22. Inspektorët kontrollues kryejnë kontroll sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr.8081, datë 7.3.1996, sipas akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, si dhe sipas rregullores së miratuar nga KMS-ja në zbatim të nenit 83 të ligjit të sipërpërmendur.

23. Për kryerjen e kontrollit mbi shoqëritë e sigurimeve inspektorët kontrollues:

23.1. ushtrojnë kontrollin administrativo-kontabël mbi aktet e administrimit të shoqërive;

23.2. kontrollojnë respektimin e akteve ligjore dhe nënligjore nga organet e shoqërive të sigurimit;

23.3. ndjekin zbatimin e akteve të KMS-së dhe e përfaqësojnë atë, me një autorizim me shkrim, përpara organeve të administratës shtetërore dhe organeve gjyqësore;

23.4. ndjekin dhe vërtetojnë mbajtjen e rregullt të kontabilitetit dhe korrespondencën e bilancit përfundimtar me rezultatet e librave dhe të llogarive kontabël.

24. Inspektorët, rast pas rasti, për të ushtruar detyrën që u ngarkohet nga KMS-ja apo kryetari i saj, duhet të veprojnë vazhdimisht dhe me iniciativë, si dhe kanë të drejtë të kërkojnë çdo dokument, shkresë, akt, apo provë shkresore nga shoqëritë që do të jenë objekt i kontrollit të tyre, si dhe të kërkojnë të gjitha dokumentet nga burimet prej të cilave kanë origjinë ato shpenzime që kanë lidhje të drejtëpërdrejtë me operacionet e sigurimit dhe/ose të risigurimit, si dhe investimet e rezervave të sigurimit.

25. KMS-ja do të kryejë kontrollin nëpërmjet personelit profesional sipas rregullores për

kontrollin, në intervale kohe të rregullta kur e çmon të nevojshme, si dhe në çdo rast tjetër, kur e sheh të domosdoshëm.

26. Propozimet, vërtetimet dhe kundërshtimet e inspektorëve kontrollues duhet t'i paraqiten KMS-së brenda 10 ditëve nga hartimi i tyre dhe, në të njëjtën kohë, duhet të regjistrohen në një libër të veçantë.

27. Relacioni për shoqërinë e kontrolluar firmoset nga të gjithë inspektorët që kanë marrë pjesë në kontroll. Nëse njëri nga inspektorët ka vërejtje për relacionin përkatës, ai nënshkruan, duke bërë njëkohësisht vërejtjet.

28. Relacioni i inspektorëve kalon për shqyrtim në mbledhjen e KMS-së dhe, pasi gjykohet dhe miratohet nga ky i fundit, i bëhet i ditur shoqërisë së kontrolluar, duke ia komunikuar këshillit të mbikëqyrjes apo drejtorisë. Ato i njoftohen edhe ekspertëve kontabël të autorizuar të shoqërisë së kontrolluar.

Struktura organizative e KMS-së

29. Struktura organizative e KMS-së i bashkëlidhet projektbilancit dhe miratohet nga kryetari i KMS-së.

30. Të drejtat dhe detyrat e personelit përcaktohen me anë të rregullores së brendshme të KMS-së, duke iu referuar kritereve të fiksuara nga kontratat kolektive të punës që janë fuqi në sektorin e sigurimeve. Inspektorët kontrollues, në ushtrimin e funksionit të tyre, janë nëpunës publikë. Ata kanë detyrë që të raportojnë të gjitha parregullsitë e vëna re në KMS.

31. Marrja në punë e personelit realizohet me konkurs me provime. Komisionet e provimit caktohen nga kryetari i KMS-së.

32. KMS-ja organizon edhe kurse periodike, për azhurnimin profesional të personelit, në mënyrat e përcaktuara nga kryetari.

Të ardhurat dhe shpenzimet

33. Shpenzimet e çdo natyre, për zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore, që lidhen me mbikëqyrjen në fushën e sigurimeve, përballohen nëpërmjet kontributeve të shoqërive të sigurimit. Këto kontribute do të derdhen nga shoqëritë e sigurimeve në llogarinë e KMS-së çdo muaj, brenda datës 10 të muajit pasardhës. Derdhja do të bëhet në llojin e monedhës që arkëtohet primi i sigurimit ose kuotat. Në fund të çdo viti financiar KMS-ja bën rakordimin përkatës me shoqëritë e sigurimeve në bazë të përcaktimeve të bëra më sipër.

34.Të ardhurat e KMS-së përbëhen:

34.1. nga të ardhurat e kontributit të mbikëqyrjes, sipas nenit 14, të ligjit nr.8081, datë 7.3.1996;

34.2. nga të ardhurat e shitjes së pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme;

34.3. Nga çdo e ardhur tjetër e mundshme sipas ligjit.

35. Shpenzimet e KMS-së përbëhen:

35.1. Shpenzimet për pagat dhe shpërblimet e anëtarëve të KMS-së dhe për personelin administrativ e kontrollues.

35.2. Shpenzime të tjera për personelin.

35.3. Shpenzime për kuota anëtarësimi në organizmat ndërkombëtarë.

35.4. Shpenzime për kontrollin dhe mbikëqyrjen.

35.5. Shpenzime për përmirësimin e legjislacionit dhe për studimin e tregut të sigurimeve.

35.6. Shpenzime për investime me karakter administrav.

35.7. Shpenzime të tjera administrative, sipas klasifikimit në planin e përgjithshëm kontabël.

Bilanci

36. KMS-ja është i detyruar që të hartojë bilancet paraprake dhe përfundimtare, në përputhje me ligjin nr.7661, datë 19.1.1993 "Për kontabilitetin".

37. Bilancet miratohen nga Ministri i Financave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.